



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 895/6 prot.

Tiranë, më 24.12.2020

VENDIM
Nr.200, datë 24.12.2020

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË ZBATIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 161, DATË 25.11.2020, NË INSTITUCIONIN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 161, dt. 25.11.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”*, ku shprehimisht është kërkuar: *“Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”*, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, institucion varësie i Ministrisë së Brendshme. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 3895/1 prot., datë 15.06.2020, nga ana e Ministrisë është raportuar, ndër të tjera, në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, vendimin paralajmërues me Nr. 161, dt. 25.11.2020, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 2/16H-1 prot., datë 14.12.2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit: ***** , në pozicionin e punës “*Specialist, Sektori i Armatimit dhe Pajisjeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë*”, ***** , në pozicionin e punës “*Specialist, Sektori i Financave, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës*” dhe ***** , në pozicionin e punës “*Sektori i Financave, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Pozicionet respektive të punës janë shpallur pozicione të lira, për t’u plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 161, dt. 25.11.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
3. Të njoftohet për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Brendshme dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha